



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 13.03.2023)

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:15 dhe mbaroi në orën 12:35.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>3. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>5. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>6. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>8. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>9. Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami, si dhe anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Klodian Kurushi.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*

2. Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Këshilltare Ligjore pranë Njësisë Mbështetëse pranë Komisioneve të Përhershme të Këshillit.

3. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

4. Valbona Bala, Përfaqësuese EWMI-INL.

5. Staf administrativ i KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).¹

Çështja e cila është për trajtim, sipas njoftimit të bërë, në rendin e ditës së sotme datë 13.03.2023, ora 12:00, lidhet me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.

Fjala i jepet relatorit të çështjes, z. Alban Toro për të relatuar relacionet e përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Zoti Toro merr fjalën duke propozuar fillimisht radhën e procedurave të shortit:

Gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, sipas kësaj radhe:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës; Gjykata e rrethit gjyqësor Mat, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet.

Gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit administrativ: Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër.

Pasi anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime me radhën e procedurave të shortit, vijohet me relatimin e relacioneve përkatëse.

Për sa i përket kërkesës së ardhur nga **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës**, ajo ka paraqitur nevojë për 4 çështje gjyqësore, në lëndë penale (lexohen të dhënat e çështjeve që do t'i nënshtrohen procedurës së shortit sipas tabelës në relacion).

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i

¹ Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 4 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë (për çështjet me numër rendor nga 1-3) dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë (për çështjen me numër rendor 4 në tabelë).

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 4 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 3.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve, në ndryshim nga rregulli i përgjithshëm të mos përjashtohen nga shorti zëvendëskryetarët në detyrë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë dhe Krujë, konkretisht: z. Aulon Pashaj dhe znj. Alma Kolgjoka.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 2, penale, kërkesa nr. 186, gjyqtarja Ermelinda Fejzo.

Për çështjen nr. 1, penale, kërkesa nr. 134, gjyqtari Aulon Pashaj.

Për çështjen nr. 3, penale, kërkesa nr. 187, gjyqtarja Ermelinda Fejzo.

Për çështjen nr. 4, penale, kërkesa nr. 188, gjyqtarja Alma Kolgjoka.

Vijohet me kërkesën e **Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat**, e cila ka paraqitur nevojë në 1 çështje, në lënde civile.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykata, nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 2 (dy).

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjes, në ndryshim nga rregulli i përgjithshëm të mos përjashtohet nga shorti zëvendëskryetarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, konkretisht: znj. Nertila Kape.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, civile, kërkesa nr. 192, gjyqtarët Xhevdet Lika dhe Ardit Kuka.

Vijohet me kërkesat e **Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec**, e cila ka paraqitur nevojë në 3 çështje.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 3 (tre) çështjeje gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 3 (tre) çështjeje gjyqësore të veçanta, të jetë nga 2 (dy).

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve, të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, konkretisht: z. Besnik Shehu.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për kërkesën nr. 170, gjyqtarët Gentiana Shukullari dhe Luljeta Kole.

Për kërkesën e ardhur nëpërmjet e-mailit të datës 06.03.2023, gjyqtarja Gentiana Shukullari.

Për kërkesën nr. 158, gjyqtarja Luljeta Kole.

Vijohet me kërkesën e **Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier**, e cila ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë civile.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1 (një).

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjes, të përjashtohet nga shorti zëvendëskryetarja në detyrë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë: znj. Ersida Bajgora.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, civile, kërkesa me nr. 1365, gjyqtarja Ersida Bajgora.

Vijohet me kërkesat e **Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet**, e cila ka paraqitur nevojë në 10 çështje, në lëndë civile (1-4) dhe në lëndë penale (5-10).

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit të KLGJ-së “Për rregullat

dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e çështjeve me numër rendor nga 1-9, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, ndërsa për çështjen me numër 10 në tabelë të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 10 çështjeje gjyqësore të veçanta, të jetë 6.

Për çështjet nga nr. 1 - nr. 9 në tabelë, për të cilat kërkohet nga 1 gjyqtar, të përzgjidhet me short 1 i tillë nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

Për çështjen nr. 10, për të cilën kërkohet 3 gjyqtarë, të përzgjidhen me short 3 të tillë nga gjyqtarët e gjykatës së rrethit gjyqësor Vlorë.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjes, në ndryshim nga rregulli i zakonshëm të mos përjashtohet nga shorti Kryetarja në detyrë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, konkretisht: znj. Suela Dashi.

Në shortimin e çështjes me numër rendor 10 të përjashtohet nga shorti zëvendëskryetari i gjykatës së rrethit gjyqësor Vlorë: z. Enkel Pezal; dhe znj. Vjola Canaj për shkak të ngarkesës.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 6, penale, kërkesa nr., gjyqtari Arben Dosti.

Për çështjen nr. 4, civile, kërkesa nr. 124, 168-27gjyqtarja Suela Dashi.

Për çështjen nr. 9, penale, kërkesa nr. 168-48, gjyqtari Gjergji Baçi.

Për çështjen nr. 1, civile, kërkesa nr. 882-113, gjyqtari Arben Dosti.

Për çështjen nr. 7, penale, kërkesa nr. 168-28, gjyqtarja Suela Dashi.

Për çështjen nr. 3, civile, kërkesa nr. 882-129/94, gjyqtari Gjergji Baçi.

Për çështjen nr. 8, penale, kërkesa nr. 168-26, gjyqtari Arben Dosti.

Për çështjen nr. 5, penale, kërkesa nr. 216, gjyqtarja Suela Dashi.

Për çështjen nr. 2, civile, kërkesa nr. 882-38/108, gjyqtari Gjergji Baçi.

Për çështjen nr. 10, penale, kërkesa nr. 168-46, gjyqtarët Arbana Selmanaj (relatore), Dorina Stroka dhe Mirela Mishgjoni (anëtare).

Vijohet me kërkesën e **Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë**, e cila ka paraqitur nevojë në 1 çështje.

Për nevojat si më lart të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë nga 1 (një).

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në ndryshim nga rregulli i përgjithshëm, në shortimin e çështjes, të mos përjashtohet nga shorti zëvendëskryetari në detyrë i Gjykatës administrative të Shkallës së Parë Vlorë, konkretisht: z. Hazbi Balliu.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 2, kërkesa me nr. 86, gjyqtari Edison Tatoshaj.

Nga zoti Rusi, ndër të tjera parashtrohet se, në relacionin për caktim gjyqtari në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë janë cituar në tabelë dy çështje, kërkesa me numër 86 (për të cilën u hodh shorti) dhe kërkesa me nr. 702 (për të cilën nuk është hedhur short).

Në përgjigje të sa më sipër, zonja Alicanaj, shprehet se kërkesa me nr. 702 e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë është shortuar më parë nga Komisioni dhe gjykata do të përcjellë pranë KLGJ-së heqjen dorë nga kjo kërkesë. Kërkesa ka ardhur një herë me e-mail dhe një herë në rrugë postare.

I pyetur nga zoti Rusi nëse edhe relatori është dakord për kërkesën me nr. 702, zoti Toro shprehet se është dakord për sa kohë që këto ishin gjithsej kërkesat e trajtuara nga KZHK-ja, duke pasur parasysh edhe situatat e fundit.

Duke qenë se konstatohet që nuk ka çështje të tjera për t'u trajtuar, me përfundimin e shortit, mbledhja deklarohet e mbyllur.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor